



Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

### NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit tjerë, që të marrin pjesë në seancën e VII-të të rregullt të punës për vitin 2018.

Seanca mbahet më 31.07.2018 (e premte), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën 10:00.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Për këtë seancë propozohet ky

### RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa,
5. Raportimi i Kryetarit për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe zbatimi i planeve investuese të komunës për gjashtëmujorin e I-re të vitit 2018 ( ref.Kryetari i Komunës)
6. Shqyrtimi i Raportit për menaxhimin financiar të Komunës për periudhën Janar -Qershor 2018 (ref. Drejtori i FEZH),
7. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Klinës për vitin 2017 (ref. Drejtori i Drejtorisë së FEZH),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për transfer/rialokim të mjeteve për projekte kapitale nga buxheti i vitit 2018
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft –Rregullores për kushtet dhe mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve në Komunën e Klinës, (referon drejtori i Drejtorisë së SHPE),
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për rikthimin e ngastrës kadastrale 446/3 ZK-Klinë, pronë e Kombinatit Bujqësor “Malishgan”, në pronësi të Komunës për realizimin e interesit publik.

01Nr. 06-4991/2018  
Klinë, më 19.07 2018

